


“

“Me siguri do ta dinim nëse skllavëria moderne është e pranishme në komunitetet tona. Ndoshta jo! E vërteta është se skllavëria moderne ndodh para syve tanë, por pa ditur se çfarë të kërkojmë, nuk mund ta ndalojmë.”

**IDM Albania** prej 10 - 16 Mars 2022 u bë pjesë e fushatës ndërkombëtare të **CNN** #MyFreedomDay2022 dhe organizoi për herë të parë në Shqipëri një javë aktivitetesh ndërgjegjësuere me të rinjtë e shkollave të mesme të përgjithshme në mbarë vendin.

Kjo fushatë drejtohet nga të rinjtë për të rritur ndërgjegjësimin për trafikimin e qenieve njerëzore si brenda shkollave dhe në komunitetet e tyre.

**# MY FREEDOM DAY 2022**



Të rinjtë nga 18 qytete të vendit realizuan aktivitete ndërgjegjësuere si video-film për martesat e detyruara, ekspozita pikturë se si e shohin ata skllavërinë moderne, biseda në komunitet me përfaqësues të institucioneve vendore (policia, bashkia) dhe orë edukative nga psikologët e shkollës. Të rinjtë kanë prekur aspekte sociale dhe kulturore përmes krijimeve për të shprehur kuptimin e tyre për lirinë.

Gjithashtu, të rinjtë u bënë pjesë e emisionit "Dita jonë" në televizionin A2CNN dhe "Dimensioni 4" në TVSH për të folur mbi skllavërinë moderne dhe aktivitetet që kanë realizuar në kuadër të kësaj nisme. Emisioni solli perspektivat e të rinjve mbi atë se çfarë është skllavëria moderne dhe roli i tyre për të parandaluar fenomenin.

1. Të rinjtë e gjimnazit "Tomorr Sinani" Cërrik përcjellin mesazhin e tyre ndërgjegjësuere me një video-monolog që na prek të gjithëve dhe tregon më së miri realitetin në të cilin jetojmë.  
<https://www.facebook.com/730990490300144/videos/7955217411170608>
2. Nxënësit e gjimnazit "Oso Kuka" Shkodër bëhen bashkë një ZË për të demaskuar skllavërinë moderne.  
<https://www.facebook.com/shkollaime.shqk/videos/647813522952226>
3. Në gjimnazin "Haxhi Qehaj" Rrogozhinë, nxënës së bashku me mësuesen koordinatore të SHQK-së, iu bashkuan nismës përmes një diskutimi të lirë me psikologjen e shkollës mbi skllavërinë moderne; përmes pikturave dhe poezive të krijuara nga nxënësit.  
<https://www.facebook.com/100022496587984/videos/pcb.1133066440786565/3171454889742580>
4. Nxënës nga gjimnazi "Ibrahim Rugova" Kamëz shprehën mendimet e tyre përmes pikturës, të paraqitura në një ekspozitë me tematikë "Skllavëria moderne dhe liria".  
<https://www.facebook.com/ibrahimrugovahighschool/photos/pcb.2093785230787333/2093785567453966/>
5. "Burgu i vetëm i vërtetë është frika dhe liria e vetme e vërtetë është liria nga frika." Një ndër thëniet që të rinjtë e gjimnazit "Zihni Magani" Peqin kanë shprehur për të përkufizuar lirinë përmes nismës së tyre.  
<https://www.facebook.com/1688732658104766/videos/390314576255563>



6. Të rinjtë e gjimnazit "Skënderbeu" Krujë realizuan video të ndryshme dhe ndanë mendimet e tyre mbi format e skllavërisë moderne gjatë një takimi me bashkëmoshatarët.

<https://www.facebook.com/Gjimnazi-Skenderbeu-Kruje-525334187569501/videos/pcb.4323155807787301/331972142319678>

7. Të rinjtë nga gjimnazi "Halit Bërzështa" Prrenjas përgatitën disa video për mënyrën se si e shohin ata skllavërinë moderne në shoqërinë e sotme.

<https://www.facebook.com/shkollaime.shqk/videos/518984839652355>  
<https://www.facebook.com/100011423824773/videos/905979213402301>

8. Nxënësit e gjimnazit "Shote Galica" Fushë Krujë i thonë STOP skllavërisë moderne! Ata zgjodhën përgatitjen e një dokumentari për të rritur ndërgjegjësimin.

<https://www.facebook.com/photo/?fbid=457938739457859&set=pcb.457942076124192>

9. Një numër i veçantë i revistës së gjimnazit "Sadik Stavileci" Kashar iu kushtua tematikës së skllavërisë moderne në kuadër të #MyFreedomDay.

<https://www.facebook.com/Sadik-Stavileci-Faqja-Zyrtare-931827546882926/photos/pcb.5013769312022042/5013768718688768/>

10. #MyFreedomDay2022 erdhi përmes të rinjve nga gjimnazi "M.K.Ataturk" Pajovë me një video sensibilizuese rreth konceptit të lirisë, ku në fokus ishin martesat e hershme.

<https://www.facebook.com/mustafakemalatalurkpagjove/videos/1456218345205201>

11. "Sepse të jesh i lirë nuk do të thotë thjesht të heqësh zinxhirët e dikujt, por të jetosh në një mënyrë që respekton dhe rrit lirinë e të tjerëve." Ky është mesazhi i të rinjve nga gjimnazi "Arbëria" Bulqizë i përcjellë përmes pikturave të krijuara plot talent nga të rinjtë.

<https://www.facebook.com/GjimnazARBERIA/photos/pcb.5058947404159728/5058937474160721/>

12. "Çfarë është liria për ty?" Ndiqni videon për të parë se si i janë përgjigjur kësaj pyetjeje të rinjtë nga gjimnazi Manëz.

<https://www.facebook.com/100047654287823/videos/5115172501931206>

13. Nxënës nga gjimnazi "Arif Halil Sulaj" Mamurras kanë zgjedhur të trajtojnë temën e skllavërisë moderne përmes podcastit të tyre "Shfleto të Ardhmen". Të rinjtë janë fokusuar tek rëndësia e rolit të grave dhe vajzave në shoqëri.

[https://open.spotify.com/episode/179nZxGCCeBmCKC68TCPXs?si=SzERZbKDScmF\\_uVbqabuNQ&fbclid=IwAR1t6D3bB7xBNA0-bybLYZ\\_QAN-GK77vJ6FXCjZvVP4RsbiVm1fpgTI4nrQ&nd=1](https://open.spotify.com/episode/179nZxGCCeBmCKC68TCPXs?si=SzERZbKDScmF_uVbqabuNQ&fbclid=IwAR1t6D3bB7xBNA0-bybLYZ_QAN-GK77vJ6FXCjZvVP4RsbiVm1fpgTI4nrQ&nd=1)

14. "A është vallë skllavëria moderne e pranishme në komunitetin tonë? A di ndokush ndonjë histori të përjetuar apo të dëgjuar nga të afërm ose miq?" Përmes një prezantimi të shkurtër dhe diskutimeve mes tyre, nxënësit e gjimnazit "16 Shtatori" Shijak u informuam mbi format e skllavërisë moderne dhe çfarë përfaqëson ajo sot.

<https://www.facebook.com/Gjimnazi-16-Shtatori-Shijak-faqja-zyrtare-775427465896992/photos/pcb.4496788033760898/4496782800428088/>

